

Drive

PORSCHE
ALBANIA

12/18



10 New Audi Q3 16 New T-Cross 20 New SEAT Terraco



LETËR 100% E RIKIKLUAR
100% RECYCLED PAPER

Përmbajtja

Content

Praktika përtej teorisë
Practice over theory

06



Makina ime
My car

08



ŠKODA SCALA

11



Spiunë të Fshehur
Spies in Disguise

14



Biznese që lëvizin me “korent”
Businesses that move on “electricity”

18



I dashur lexues, Dear Reader,

Erilda Hoxha - Drejtor Marketingu Porsche Albania
Marketing Manager Porsche Albania



> Përshëndetje të gjithëve, unë quhem Erilda Hoxha, jam pjesëtarja më e re në Porsche Albania-s dhe do të drejtoj departamentin e Marketingut & PR në Porsche Albania. Pas kryerjes së studimeve të larta jashtë vendit dhe pas disa përvojave në treg, pata kënaqësinë t'i bashkohen Porsche Albania. Eksperienca në industrinë automobilistike është sa interesante aq edhe sfiduese dhe do të mundohem të ndaj me ju evente, informacione dhe histori suksesi të cilat do t'i mbajmë mend gjatë.

Nga botimi ynë i fundit Drive, nuk ka kaluar shumë kohë, por dimri erdhi shpejt, sikurse edhe numri ynë i radhës. Në këtë numër do të gjeni modelet e reja të grupit Volkswagen që deri më sot mund të kenë qenë të panjohura për ju. Sikurse dhe lajme dhe risi nga industria e automobilave. Audi si asnjëherë më parë, përveçse vjen me një model tërësisht elektrik,

tashmë është dhe pjesë e një filmi të animuar me agentë specialë.

Volkswagen ju surprizon me një SUV compact dhe jo, nuk është T-roc, nuk është as Tiguan. Emrin dhe jo vetëm, i gjeni në faqen 11. Urojini mirëseardhjen anëtarit më të ri të familjes, Skoda zbulon edhe emrin e modelit të ri që do t'i shtohet gamës së prodhuesit çek të makinave. Scala do të jetë emri i modelit më të fundit që latinisht do të thotë shkallë. Të jetë ky vallë modeli që do të ndihmojë Skodën të ngjisë shkallët e suksesit? Ashtu si çdo tetor, edhe këtë vit kryeqyteti francez mirëpriti Paris Motor Show ku shtëpitë më të mëdha automobilistike prezantuan risitë e tyre. SEAT prezantoi modelin Tarraco, SUV-in ekskluziv të markës spanjolle. Me këto dhe më tepër do të njiheni në vazhdim.

Por, nuk dua të ndalem vetëm në risitë që do të kemi në 2019. Për lexuesit e Revistës Drive

dhe të gjithë partnerët tanë, dua t'ju percejll nje mesazh urimi nga administratorët e kompanisë, Christoph Erlmoser dhe Gentian Bushati:

"Këtë vit, falë besimit tuaj dhe dedikimit të stafit profesional dhe të përkushtuar të Porsche Albania, ne ia dolëm të jemi kompania nr.1 në tregun automobilistik në Shqipëri. Për këtë arritje, duam t'ju falenderojmë juve që na besuat dhe stafin e mrekullueshëm të Porsche Albania. Viti që po afroh na sjell sfida të reja, të cilat jemi të sigurt që do i kthejmë në histori suksesi. Gjejmë rastin të urojmë nga zemra të gjithë klientët, partnerët dhe kolegët. Gëzuar festat e fundvitit. Ju urojmë një Vit të Ri sa më të shëndetshëm dhe të lumtur për Ju dhe të dashurit tuaj!"

Lexim të mbarë!

> Hello everyone. My name is Erilda Hoxha and I am the newest member of Porsche Albania's team. I will be heading the Marketing and PR Department at Porsche Albania. After my studies abroad and after some experiences in the market, I have the pleasure to join Porsche Albania. Experience in the automobile industry is as interesting as it is challenging and I will try to share with you events, information and success stories that we will keep in mind for long.

Not much time has passed by since our latest Drive magazine issue, but the winter has arrived fast as has our next edition. In this issue, you will find the newest models of the Volkswagen Group, which to date may have been unknown to you. You will also find news and novelties from the automobile industry. Like never before,

Audi not only comes with a fully electric version, but it is now also part of an animated movie with special agents.

Volkswagen surprises you with a compact SUV and, no, it is not T-Roc, nor is it Tiguan. You will find the name and much more on page 11. Give a welcome to the newest family member. Škoda discovers the name of the new model that will be added to the variety of the Czech carmaker. Scala will be the name of the latest model. In Latin, it means ladder; will this be the model to help Škoda climb the steps of success? As every October, the French capital hosted the Paris Motor Show, where the largest automobile brands introduced their novelties. SEAT introduced the Tarraco model, the exclusive SUV of the Spanish brand. You will find more information about these and more in the following pages.

I do not want to talk only about the novelties of 2019. For the Drive Magazine readers and all our partners, I wish to convey a message of wishes from company administrators Christoph Erlmoser and Gentian Bushati: "This year, thanks to your confidence and the dedication of the professional and committed staff of Porsche Albania, we managed to be the no.1 company in the automobile market in Albania. For this achievement, we wish to thank you for trusting us and the excellent staff of Porsche Albania. The coming year brings new challenges, which we are certain we will turn into success stories. We take advantage of this opportunity to wish all customers, partners and colleagues from our hearts: Happy Holidays! We wish a healthy and happy New Year for you and your loved ones!"

Happy reading!



Drejt së “gjelbrës” Toward “green”



Mjetet e përdorura të importit do të jenë më të pastra.

Shqipëria është e mbushur me makina të vjetra. Sipas të dhënave nga Automobile Club Albania (ACA), parku i automjeteve në Shqipëri ka një moshë rreth 20-vjeçare, nga 10.2 që është moshë mesatare në Bashkimin Europian. Nga viti 2011 deri në shtator 2018, në Shqipëri janë treguar gjithsej 302 mijë automjete, me një mesatare prej rreth 30 mijë në vit, sipas të dhënave nga Drejtoria e Transportit Rugor dhe ACA, të cilat janë përpunuar nga Qendra e Kërkimeve Monitor (QKM). Afro 92% e këtyre automjeteve kanë një vit prodhimi deri në 2008-n, pra sot janë mbi 10 vjet të përdorura. Tendencia ka vijuar edhe në 2018-n. Për 9 muajt e këtij viti u treguan gjithsej 38 mijë automjete, nga të cilat vetëm 6,649, ose 17% ishin të prodhuara pas vitit 2008, pra ishin më pak se 10 vjet të përdorura. Në 2018-n, hyjnë ende makina që janë prodhuar që në vitin 1985, pra që janë në përdorim prej 33 vitesh, teksa janë treguar 108 automjete të tilla, sipas të dhënave zyrtare nga Drejtoria e Transportit Rugor. Mjetet e “preferuara” të shqiptarëve kanë një vit prodhimi mes 2000 dhe 2008, teksa përbënin 77% të targimeve totale për 9-mujorin. Por, nga 2 dhjetori, ka hyrë në fuqi vendimi i Këshillit të Ministrave, që ndalon importin e automjeteve që janë të përdorura më shumë se 10 vjet, duke ndikuar mesatarisht 80% të totalit të importeve vjetore. Mjetet e reja që do të hyjnë duhet të përmbushin normën Euro 5, si për makinat ashtu dhe kamionët, ndërsa autoveturat e përdorura, që përmbushin normën Euro 4, duhet të jenë prodhuar jo më shumë se 10 vjet para datës së regjistrimit të parë në Shqipëri. Në lidhje me këtë zhvillim i kemi marrë një mendim menaxherit të përgjithshëm të Porsche Albania, Z. Gentian Bushati.

Z. Bushati si e vlerësoni vendimin e fundit të qeverisë për ndalimin e makinave të përdorura mbi 10 vjet?

Mendoj se ky ndryshim ligjor do t'i shërbejë mjedisit, më shumë sesa tregut të makinave të reja. Mendoj se si çdo nismë që përmirëson cilësinë e jetës për ne dhe fëmijët tanë, duhet të jetë e mirëpritur nga bashkëqytetarët. “Parku i makinave në Shqipëri është shumë i vjetër. Kjo sjell shumë probleme për ndotjen, por edhe për sigurinë në rrugë, që tashmë është bërë një problem i madh, i shkaktuar jo vetëm nga pakujdesia e shoferëve. Përfituesi i madh do të jetë publiku dhe tregu i makinave të përdorura”.

Si pritët të ndikojë vendimi në tregun e automjeteve në vend?

Kjo nismë do të ketë dy të mira për sa i përket tregut të makinave të përdorura, pasi siç e thashë më lart, nuk pritët të ketë efekt pozitiv të menjëhershëm të tregu i makinave të reja. Së pari, do të rrisë dhe do të krijojë mundësi që parku i makinave në Shqipëri të fillojë të “rinohet”. Së dyti, vlera e stokut apo e makinave të përdorura që regjistrohen për herë të dytë do të rritet. Kjo gjë do të ulë importin e makinave të përdorura për 6-mujorin e parë të vitit që vjen. Më pas, tregu do ta rimarrë veten dhe besoj do të jemi në shifrat diku 40,000 makina të përdorura për 2019.

Cilat janë politikat që ju sugjeroni se duhet të ndërmarrë qeveria shqiptare, për të nxitur tregun e automjeteve të reja në vend?

Referuar qëllimit të këtij ligji për përmirësimin e ndotjes së shkaktuar nga mjetet motorike me djegie të brendshme, mendoj se qeveria duhet të ndryshojë politikat e saj, në mënyrë që të nxisë blerjen e makinave të reja që shkaktojnë shumë më pak ndotje, ose ato që

nuk shkaktojnë ndotje fare, siç janë makinat elektrike. Këto makina kanë sot një çmim relativisht të lartë, për arsye të kostove të larta të prodhimit ndaj mendoj se duhen lehtësi për të përkrahur blerësit e këtyre makinave, në formë bonusesh ose ulje të TVSH, sepse ato kanë ndikim pozitiv në mjedis dhe në komunitet dhe taksat tona është e mira të rishpërndahen për këta përfitues. Shteti duhet të jetë i angazhuar të ulë ndotjen e parkut të makinave të tij, pasi janë shumë të vjetra. Mendoj se në këtë rast, Bashkia e Tiranës është një shembull i mirë për tu ndjekur nga qeveria qendrore. Ka ardhur koha për hartimin e një strategjie për vendosjen e karikuesve apo detyrimi i pikave të karburantit që të kenë karikues të tillë për makinat elektrike. Mendoj se e ardhmja është tani!

Si ka qenë ecuria e kompanisë suaj së fundmi dhe cilat janë sfidat e së ardhmes?

Porsche Albania vëren se tregu këtë vit përsëri do të ketë rritje në krahasim me vitin 2017, por vlen të theksohet se rritja dyshifrore në 2016 apo 2017 nuk do të jetë e mundur. Kjo rritje me rënie, do të thosha unë, e ka burimin të forca blerëse në treg e individëve që ka rënë shumë. Kompanitë janë ai grup i tregut që po rritet, ndërsa përditë e më shumë individët po blejnë më pak se dy vite më parë. E megjithatë, ne në Porsche Albania jemi pozitivë që rezultati ynë do të jetë një vit tjetër rekord për sa u përket numrave të makinave të dorëzuara në treg. Rreth një në tre makina të shitura në Shqipëri ka dalë nga portat e Porsche Albania, nga markat lider në treg sot për sa i përket numrave si Volkswagen apo Skoda të ndjekura nga Audi dhe Seat. Gjithashtu në tregun e makinave të përdorura ku ne jemi të pranishëm me Das WeltAuto Albania, ne do të arrijmë një vit tjetër rekord shitjesh.



Gentian Bushati - Drejtor i përgjithshëm Porsche Albania
General Manager Porsche Albania



➤ Imported used vehicles will be cleaner

Albania is filled with old cars. According to data from Automobile Club Albania (ACA), the vehicle park in Albania is about 20-years old, compared to the European Union average that is 10.2 years. From 2011 until September 2018, a total of 302,000 vehicles received license plates in Albania, at an average of 30,000 per year, based on data from the Directory of Road Transport and ACA, processed by the Monitor Research Center (MRC). About 92% of these vehicles were produced up to 2008 and presently have been used for over 10 years. The trend continued also in 2018. For the first 9 months of this year, a total of 38,000 vehicles were issued license plates, of which only 6,649 or 17% were produced after 2008, i.e. were used for less than 10 years. In 2018, there are still vehicles produced since 1985 that are brought in, i.e. in use since 33 years, while 108,000 such vehicles have been issued license plates, according to data from the Directory of Road Transport. The "favorite" vehicles of Albanians have a production year between 2000 and 2008, while they represented 77% of total license plates issued for the first 9 months. As of December 2, a Council of Ministers' decision has entered into effect that prohibits the import of vehicles that have been used for more than 10 years, thus affecting an average of 80% of the total of annual imports. The new vehicles that will enter the country should meet the Euro 5 standard, both for vehicles and trucks, while used cars that meet the Euro 4 standard should have been produced no more than 10 years before the date of first registration in Albania. We conducted an interview with Mr. Gentian Bushati, General Manager at Porsche Albania

How do you view the latest government decision to prohibit cars that have been used for over 10 years?

I think this legal change will benefit the environment more than it will benefit the new vehicle market. I think that any initiative that improves the quality of life for our children and us should be welcome by citizens. **"The vehicle stock in Albania is very old. This causes many problems in terms of pollution, but also road safety, which now has become a major problem, caused not only by careless drivers. The great beneficiary will be the public and the market of used vehicles"**.

What impact is the decision going to have on the vehicle market in the country?

This initiative will have two benefits with regard to the used vehicle market; as I said above, it is not expected to have an immediate positive impact on the new vehicle market. First, it will increase and create opportunities for the vehicle market in Albania to become "younger." Second, the value of the stock of vehicles registered for the second time will also increase. This will lead to a reduction in the import of used cars for the first and second quarters of the coming year. Afterwards, the market will pick up and I believe we will be at about 40,000 used vehicles for 2019.

What further policies do you suggest the Albanian Government should undertake in order to encourage the new vehicle market in the country?

Referring to the purpose of this law to improve pollution caused by internal combustion engines, I think the government should amend its policies in order to encourage the purchase of new vehicles that cause much less pollution, or those that do not cause any pollution, such

as electric cars. These vehicles presently are at a relatively high price due to high costs (the battery or advanced technology used in them), which is why I think these buyers who, I think have a responsible conscience, should be encouraged in forms such as making VAT zero, giving funds as support for buyers of these electric vehicles, because they have a big impact on the environment and, as a result, on communities, and it would be good to redistribute our taxes to these beneficiaries. The state should be engaged to reduce the pollution of its car stock because they are very old. I think in this case, Tirana Municipality is a good example to be followed by the Central Government. Drafting a strategy for charging stations and their location within at least the small ring road or forcing fuel stations to have such charging points for electric vehicles. I think the future is now!

How has your company been doing recently and what are the challenges of the future?

Porsche Albania notes that the market again will see an increase compared to 2017 this year, but it is worth noting that the two-digit increase in 2016 or 2017 is not going to be possible. This reduced increase, I would say, originates from the purchasing power in the market, which has dropped a lot. Companies are the small part of the market that is growing, while individuals are purchasing less than two years ago. However, we at Porsche Albania are positive that our result will be another record year with regard to the number of vehicles delivered in the market, about one in every three vehicles sold in Albania came out of the doors of Porsche Albania, first of all from leading brands in the market today such as Volkswagen or Škoda, followed by Audi and Seat. In the used vehicle market, we are also present with Das WeltAuto Albania, and we'll achieve another year of record sales.

Praktika përtej teorisë

Practice over theory

Porsche Albania tashmë operon prej 13 vitesh në Shqipëri duke na bërë ekspert jo vetëm në tregun e makinave, por edhe në rekrutimin e stafit të duhur. Në 13 vite, kemi njohur më mirë nevojat tona dhe ofertën e tregut të punës duke krijuar më shumë siguri në proceset e rekrutimit. Prej 3 vitesh, Porsche Albania ka krijuar Departamentin e Burimeve Njerëzore, duke sjellë standardizim dhe zhvillim të proceseve të rekrutimit, trajnimit dhe zhvillimit të punonjësve.

Ndër proceset tek të cilat kemi rritur përpjekjet është edhe ndërtimi i programeve të praktikave mësimore pranë departamenteve tona. Ku rëndësi të veçantë kanë praktikat në departamentin e servisit pasi nevoja për staf të kualifikar profesionalisht has shpesh në mungesën e tregut të punës për të përbushur kërkesat që ne kemi.

Prej disa vitesh në bashkëpunim me shkollat e mesme profesionale mekanike dhe Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike, ne kemi marrë përsipër të trajnojmë nxënës dhe studentë për periudha 1-3 mujore. Ku kohëzgjatja e praktikës është e bazuar në kurrikulën shkollore dhe në profilet mekanik, motorist, diagnostikues etj. Gjatë programeve tona të praktikave, studentët mësojnë përkrah mjeshtërve të mekanikës, në kushtet e përditshme të ngarkesës së punës dhe me teknologjitë që markat tona mundësojnë. Duke ditur që departamenti i servisit të Porsche Albania-s mbulon të pesta markat që ne përfaqësojmë, eksperiencia pranë nesh ndihmon në ndërtimin e një kurrikule të plotësuar për këdo që kryen praktikën në servisin tonë.

Qëllimi ynë nuk kufizohet vetëm në mundësinë që i japim të rinjve për të mësuar, por edhe

të rekrutojmë studentët më të talentuar për t'i pasur pjesë të stafit, për t'i trajnuar, zhvilluar dhe për të përgatitur mjeshtër të ardhshëm të mekanikës. Me raportin 1 në 4 praktikantë të punësuar jemi të bindur se kjo mënyrë rekrutimi është e suksesshme.

Dhe sot falë ndryshimeve dhe lehtësirave në arsimin profesional, cilido student që dëshiron të zhvillojë praktikën mësimore pranë nesh mjafton të plotësojë një kërkesë zyrtare nga shkolla apo universiteti të cilit i përket dhe ta dorëzojë pranë zyrave tona të burimeve njerëzore.

Ne do të vazhdojmë zhvillimin e praktikave edhe në të ardhmen, e pse jo edhe me programe më të gjata praktikash dhe me më shumë institucione arsimore, për t'i ndihmuar këta të rinj të ndërtojnë të ardhmen e tyre profesionale.



Porsche Albania has been operating for 13 years in Albania, becoming so, not only experts in the automotive market, but also in recruiting the right human resources. In 13 years, we have become more secure in our recruiting processes as we got to know better our needs and what the labor market has to offer. In the last three years Porsche Albania has established the Human Resources Department, to standardize and develop the processes of recruitment, training and employee development.

Building internship programs for our departments is one of the processes that we have increased our efforts. Such programs have a significant importance for the workshop department, as we often encounter a lack in labor market to fulfill our needs for qualified and well trained staff.


For several years, in cooperation with professional schools and the Faculty of Mechanical Engineering, we have undertaken to train students for 1-3 month periods. The internship program is based on their academic curricula for professions like mechanics, engine mechanics and diagnostic technicians. During our practice programs, students learn side by side with our team in the daily work processes and with the best technologies that our brands provide. During the internship time in our workshop, our interns get to learn for all our brands, building so a more complete curriculum for their future.

Our goal is not only to give young students the opportunity to learn, but also to recruit the most talented interns into our team, to train, develop, and prepare future experts in the workshop department. With the ratio of 1 to 4 employed

interns we are convinced that this recruitment method is successful.

And today thanks to changes and facilitations in vocational education, any student who wants to apply as an intern at Porsche Albania has to fill out the official request from their school or university and send it to our human resources department.

We will continue developing internship programs in the future, focusing on more long-term programs and with more vocational institutions, to help these young students build their professional career.





Makina ime

My car

Viti 2019 përveç risive në modele të reja do të sjellë edhe "Makina Ime 2.0", aplikacioni i Porsche Albania tashmë në versionin e përmirësuar. Nje staf prej 5 personash i janë dedikuar ndërtimit dhe dizenjimit të këtij aplikacioni, për 960 ore punë në mundësi të realizojmë qëllimin tonë, pra automatizimin, lehtësimin e komunikimit dhe dhënien e informacionit në kohë reale për klientët dhe stafin e Porsche Albania.

Duke filluar nga muaji janar, të gjithë do të kenë mundësinë të shkarkojnë versionin e azhurnuar i cili do të jetë më efikas dhe praktik për t'i ardhur në ndihmë të gjithë klientëve nëpërmjet teknologjisë më të fundit Android dhe iOS.

Klientët do të jenë në gjendje të marrin informacion për pjesët e këmbimit të automjeteve apo të kontrollojnë faturat e servisit. Klientët do të kenë akses në një seri shërbimesh të ofruara nga aplikacioni "Makina ime". Këto shërbime përfshijnë: Pagesat e parkimeve publike, kërkime për pjesë këmbimi, kontroll i faturave të servisit, etj. Aplikacioni ju vjen në ndihmë edhe juve që keni një makinë elektrike, duke ju treguar në hartë vendndodhjen e pikave të karikimit.

Këtë vit kemi menduar edhe për përgatitjen e aspirantëve për drejtues automjeti pasi të gjithë ata që po mendojnë t'i nënshtrohen testimit të lejes së drejtimit mund të stërviten për pjesën teorike në aplikacionin tonë. Ky provim përmban pyetje reale, të njëjta me ato që ju shfaqen në monitor në momentin që ju bëni provimin e patentës.

Nëpërmjet aplikacionit mund të lidheni me faqet tona të internetit si dhe me faqen e internetit të makinave të përdorura që në disponojmë Das WeltAuto. Gjithashtu nëse po konsideroni të bëni blerjen e një makine nëpërmjet financimit leasing, ne ju mundësojmë një përlllogaritje të parapagimit dhe pagesës mujore.

Në app "Makina Ime" do të gjeni edhe ofertat më të fundit të Porsche Albania dhe sigurisht do jeni të parët që do të ftoheni në eventet tona përgjatë gjithë vitit.

Takohemi në Playstore dhe App store në 1 janar.

Year 2019, aside from new vehicle models, will also bring "Makina Ime 2.0," Porsche Albania's application in an improved version. A five-person staff were dedicated to building and designing the application and after 960 hours of work, we managed to achieve our goal – that of automation, facilitation of communication and provision of information in real time for the customers and staff of Porsche Albania.

Starting from January, everyone will have the possibility to download the updated version, which will be more efficient and practical in assisting customers through the latest Android and iOS technologies.

Customers will be able to obtain information on spare parts for vehicles or check their service

bills. Customers will have access to a series of services provided by the application "Makina Ime." These services include the payment of public parking, search for spare parts, checking on service bills, etc.

The application will be useful also to those who have an electric car, showing recharging points on the map.

This year we thought also of helping prepare aspiring drivers. All those planning to take the driving test can train on our app for the theory part. This test contains real questions, the same as those appearing on the monitor at the time you take the driving test.

Through the application, you may connect to our internet websites as well as the used cars site we possess, Das WeltAuto. Also, if you're considering purchasing a vehicle through leasing, we enable the calculation of monthly installments.

In the "Makina Ime" app, you'll find also the latest offers of Porsche Albania and you will certainly be the first to be invited to our events throughout the year.

See you on Playstore and Appstore on January 1st.



ŠKODA SUPERB Merr Çmimin 'Fituese e Auto-Provës 2018'

ŠKODA SUPERB awarded 'Auto Test Winner 2018' in Germany

> Në numrin 3/2018 të revistës 'Auto Test,' ŠKODA SUPERB 2.0 TDI 110 Kw (150hp) fitoi ndaj konkurrentëve të saj të fortë, duke arritur gjithsej 641 pikë. Makina elegante jo vetëm mori medaljen e artë në këtë krahasim të drejtpërdrejtë, por edhe arriti rezultatin më të mirë mes të gjitha makinave të importuara që u testuan gjatë 12 muajve të fundit. Revista e tregtisë thekson në veçanti "hapësirën më të mirë" dhe "sistemin infoargëtues më miqësor ndaj përdoruesit." Përfundimi: "ŠKODA është drejtuese në këtë segment. E madhe dhe shumë praktike. Komfort dhe drejtim i shkëlqyer në udhëtim."

"Jemi shumë të lumtur të marrim këtë çmim të ri për ŠKODA SUPERB, e cila e bindi panelin e 'Auto Test' me karakteristikat e saj unike," thotë Stefan N. Quarry, Shef i Shitjeve në ŠKODA AUTO Deutschland GmbH, në ceremoninë e çmimeve në Köln.

Prej vitit 2008, 'Auto Test' ka dhënë çmime për makinat më të mira nga kategori të ndryshme të dymbëdhjetë muajve të mëparshëm. Këtë vit, ekspertët vlerësuan rreth 500 makina nga të gjitha klasat dhe mbuluan më shumë se një milionë kilometra në prova. Në testet e krahasimit, kritere të tilla si cilësia dhe performanca e drejtimit e makinave luajnë një rol po aq të rëndësishëm sa edhe vlera e rishitjes, kostot shtesë dhe kostot e operimit. Në vlerësim përfshihet edhe tema e sigurisë.

ŠKODA është një prej fituesve serialë të këtij çmimi prestigjioz. Në vitin 2014 dhe 2015, ŠKODA OCTAVIA COMBI fitoi në renditjen e importeve. Në vitin 2016, ŠKODA SUPERB COMBI arriti rezultatin e gjithanshëm më të mirë mes automjeteve të importuara. Vitin e kaluar, titani plot hapësirë u rendit i dyti vetëm pas ŠKODA KODIAQ të porsa dalë në treg.



> In the 3/2018 issue of 'Auto Test' magazine, the ŠKODA SUPERB 2.0 TDI 110 kW (150 hp) prevailed over its strong competitors, achieving a total of 641 points. The elegant saloon not only took the gold medal in this direct comparison, but also achieved the best result among all imported vehicles tested over the past twelve months. The trade magazine highlights the "best space" and its "user-friendly infotainment" in particular. The conclusion: "The ŠKODA is the class leader. Huge and very practical. Excellent ride comfort and handling."

"We are delighted to receive this new award for the ŠKODA SUPERB, which convinced the panel at 'Auto Test' with its unique characteristics," says Stefan N. Quarry, Head of Sales at ŠKODA AUTO Deutschland GmbH, at the award ceremony in Cologne.

Since 2008, 'Auto Test' has been awarding the best vehicles in various categories from the previous twelve months. Every year, the experts evaluate around 500 cars of all classes and cover more than one million kilometres on test tracks. In the comparison tests, criteria such as vehicle quality and driving performance play just as important a role as the resale value, additional charges and operating costs. The topic of security is also included in the evaluation.

ŠKODA is one of the serial winners of this prestigious award. In 2014 and 2015, the ŠKODA OCTAVIA COMBI won in the import rankings. In 2016, the ŠKODA SUPERB COMBI achieved the best overall result among import vehicles. Last year, the spacious titan came second only to the newly launched ŠKODA KODIAQ.

ŠKODA SCALA: Një emër i ri për një model të ri kompakt

ŠKODA SCALA: A new name for a new compact model



> ŠKODA zbulon emrin e modelit të saj të ri kompakt – ŠKODA SCALA. Emri vjen nga latinishtja 'scala,' e cila nënkupton 'shkallën' ose 'shkallët,' duke shënuar kështu hapin e radhës për prodhuesin çek të makinave në segmentin kompakt. SCALA është modeli i parë i prodhimit ŠKODA në Europë që do të mbajë emrin ŠKODA në mes të anës së pasme në vend të logos ŠKODA.

Bernhard Maier, CEO i ŠKODA AUTO, thekson: "Me ŠKODA SCALA e re, po hapim një kapitull të ri në klasin kompakt të ŠKODA-s. Është një zhvillim krejt i ri që përcakton standardet për sa i përket teknologjisë, sigurisë dhe dizajnit në këtë klas. Kemi besim që SCALA ka shansin më të mirë për të ripërkufizuar segmentin A për ŠKODA-n."

Me SCALA-n, ŠKODA prezanton gjuhën e vet të re emocionale për anën e jashtme dhe të brendshme për herën të parë në prodhimin e serive. Tashmë ka shkaktuar një sensacion në Panairin e Makinave në Paris në formën e VISION RS. Marka tradicionale çeke po ashtu po hedh një hap përpara për sa i përket teknologjisë, duke ofruar veçori novatore në modelin e ri, të cilat deri më tani kanë qenë vetëm në segmentet më të larta. Emri SCALA, i cili vjen nga latinishtja dhe nënkupton 'shkallë,' për pasojë përputhet më së miri, teksa ŠKODA k andërmarrë një sërë hapash madhorë përpara. Po ashtu mishëron përsosmërisht vlerat e markës, të cilat i përmbledh saktësisht termi "nënvlerësim i mençur."

Gjithashtu, ŠKODA SCALA e re sjell edhe një veçori tjetër, të re dhe të pagabueshme: modeli i parë i modelit të serisë europiane ku shfaqet fjala ŠKODA fiksuar në shkronja të veçuara në vend të logos në qendër të bagazhit të modelit të ri kompakt.

> ŠKODA reveals the name of its new compact model – ŠKODA SCALA. The name comes from the Latin word 'scala', which means 'stairs' or 'ladder', signifying the next step forward for the Czech car manufacturer in the compact segment. The SCALA is the first ŠKODA production model in Europe to bear the ŠKODA lettering in the middle of the tailgate instead of the ŠKODA logo.

Bernhard Maier, ŠKODA AUTO CEO, emphasizes: "With the new ŠKODA SCALA, we are opening a fresh chapter in ŠKODA's compact class. This is a completely new development that sets standards in terms of technology, safety and design in this class. We are confident that the SCALA has the best chance of redefining the A-segment for ŠKODA."

With the SCALA, ŠKODA presents its new

emotional exterior and interior design language for the first time in series production. It already caused a sensation at the Paris Motor Show in the form of the VISION RS. The traditional Czech brand is also taking a leap forward in terms of technology, offering innovative features in the new model that so far have only been seen in higher segments.

The name SCALA, which comes from Latin meaning 'stairs' or 'ladder', therefore is a perfect match, as ŠKODA has taken several major development steps forward. It also perfectly embodies the brand's values, which the term "smart understatement" aptly summarizes.

In addition, the new ŠKODA SCALA sports another, new and unmistakable feature: the first European series model of the brand to feature the word ŠKODA affixed in individual letters instead of the logo to the centre of the boot lid of the new compact model.





Modeli i ri i Audi Q3 përfaqëson një SUV familjar, me të gjitha talentet e kërkuara në këtë segment. Në gjeneratën e dytë Q3 vjen jo vetëm më i sigurt në aspektin e dizajnit, por edhe dukshëm më i madh përsa u përket përmasave. Hapësirat e shtuara, variabiliteti që ndeshet kudo dhe detajet e pafundme praktike, e bëjnë jashtëzakonisht të përdorshëm në çdo situatë. Dizajni i Q3 të ri sugjeron forcë dhe prezencë. Paraqitja ballore e Q3 të ri dominohet nga grila tetëkëndore si dhe çarje të mëdha ajrimi. Tetë riga vertikale ndajnë grilën oktagonale duke i dhënë makinës gjerësi si dhe një karakter të dukshëm mashkullor. Fenerët, të cilët edhe në seri ofrohen në teknologjinë LED dhe si opsion Audi Matrix LED, garantojnë jo vetëm grafika tipike të markës, por edhe një ndriçim të plotë të rrugës, duke rritur dukshëm sigurinë dhe komfortin në rrugë. Profili anësor dominohet nga simetria mes fenerëve të përpamë dhe stopave të pasëm. Linja gjatësore poshtë dritareve, me parafangot muskuloze, citon përshtypjen atletike, duke të zgjuar kujtimet e quattro-s së famshme. Konturet rreth rrotave, të lyera në ngjyrë të errët përforcojnë pamjen klasike të një makine Off-road. Spoileri sportiv i montuar në çati dhe xhami i pasëm i shtrirë të japin nga çdo kënd idenë se makina është në lëvizje të vazhdueshme.

Q3 i ri, falë dimensioneve të tij pozicionohet në krye të segmentit të fuoristradave kompakte

familjare. Tipike për këtë segment është shikueshmëria shumë e mirë rreth e rrotull dhe lehtësia në hipje dhe zbritje nga makina, ndërkohë që pozicioni në sedilje te sugjeron që ndodhesh në një makinë sportive. Distanca aksiale është e madhe, duke bërë të mundur përveç hapësirës së bollshme të gjunjëve edhe një amortizim më komfort në çdo lloj rrugë. Sedilja e pasme mund të spostohet me 15 cm para - prapa ndërkohë që mbështetësja e palosshme mund të ndahet në tre pjesë 40:20:40 dhe të përkulet në shtatë variante të ndryshme. Koncepti i organizimit të hapësirës garanton praktikitet: në varësi të pozicionit të sediljes së pasme dhe mbështetëses së saj, kapaciteti i bagazhit mund të shkojë deri në 675 Litër, me sedilje të palosura madje deri në 1.525 Litër. Në kombinim me opsionin e çelësit komfort, dera e bagazhit mund të hapet dhe mbyllet me lëvizjen e këmbës. Nuk mungojnë detaje të tjera praktike si platforma e bagazhit që mund të variojë në tre pozicione të ndryshme apo pragu i ulët i bagazhit, që lehtëson futjen e objekteve të rënda në makinë.

Koncepti i multimedias në Q3 e ri është tërësisht dixhital. Madje edhe në pajisjet e serisë nuk mungon MMI Radio dhe kroskoti dixhital me madhësi 10,25 inch, i komandueshëm nëpërmjet timonit. Nëse porositet sistemi opsional MMI Navigation plus shtohet edhe një ekran tjetër Touchscreen 10,1. Për një sistem fonie të nivelit të lartë vjen si

alternativë opsionale Bang & Olufsen Premium Sound System.

Temperamenti, zhdërvjelltësia dhe siguria përbejnë prej kohesh ADN-në e Audi-t dhe Q3 i ri sigurisht që nuk mund të bënte përjashtim. Praktike në qytet, e shkathët në rrugë dytësore, potente në autostradë – në çdo terren apo situatë modeli i ri e gjen veten si në shtëpinë e tij. Distanca aksiale më e gjatë "gëlltit" shumicën e gropave apo gungave në rrugë. Nëpërmjet sistemit Audi drive select shoferi përshtat nevojat personale me kushtet e rrugës duke shfrytëzuar gjashtë profile të ndryshme, nga komforti tek sportiviteti apo kursimi maksimal. Ky sistem, ashtu si në segmentet më të larta, ndikon në sistemin e drejtimit, marrjen e gazit, karakteristikat e kamios si dhe në amortizimin opsional me rregullim. Natyrisht që edhe shoferët më sportivë nuk janë lënë pas dore – paketa e jashtme S line, përveç detajeve karakteristike vjen me amortizim më sportiv.

Komforti dhe siguria është shkruajtur gjithmonë me shkronjë të madhe për markën me katër unaza. Janë të shumta sistemet e asistencës që ofrohen për të lehtësuar punën e shoferit. Do të përmendnim Asistentin Adaptiv të shoferit, i cili integron funksionet e Asistentit Adaptiv të Shpejtësisë, Asistentin e Trafikut të Rënduar, Asistentin e mbajtjes së korsisë, duke i ofruar shoferit veçanërisht në udhëtime të gjata komfort maksimal.

New Audi Q3. All-round Talent.



> The new Audi Q3 represents a family SUV, with great all-round talents. The second-generation Q3 appears not only visually more self-evident but offers far greater utility due thanks to abundant space. Added space, adaptability and many practical details make it extremely usable for every situation.

The new Q3 design suggests strength and presence. The front of the new Q3 is dominated by the octagonal front frame and large air inlets. Eight vertical bars that divide the octagonal grille, giving the car width and an evident masculine character. The headlights, which are offered in the LED technology and as an option in Audi Matrix LED, guarantee not only typical brand graphic but also full lighting of the road, visibly boosting safety and comfort on the road. In profile, the car gets a symmetrical lighting graphics of the headlights and rear lights. The shoulder line connects them from a styling perspective and provides an athletic overall impression with strong muscles over the wheel arches, invoking memories of the famous Quattro. The wheel arch trims in dark color enhance emphasize the off-road look. A roof edge spoiler, which also flanks the rear window at the side, give the idea that the vehicle is in continuous movement.

Thanks to its dimensions, the new Q3 ranks at the top of the compact family SUV segment.

